



Arrestohen 13 persona në Deçan, u kapën duke luajtur bixhoz në një lokal – Njërit iu gjet pistoletë me 8 fishekë në veturë



18/08/2025 09:33

f

tw

link

Policia e Kosovës në bashkëpunim më Gjykatën kompetente dhe Prokurorinë Themelore, kanë arrestuar 13 persona në Deçan.

Të njëjtit janë kapur në flagrancë duke luajtur bixhoz, shkruan [lajmi.net](#).


Tek të dyshuarit janë konfiskuar vlera monetare të ndryshme, ndërsa tek njëri nga të dyshuarit, në veturën e tij i është gjetur dhe konfiskuar një pistoletë me 8 fishekë.

Të dyshuarit janë dërguar në mbajtje.

“Decan / 17.08.2025-01:05. Njësitet policore në koordinim me gjykatën kompetente dhe prokurorinë themelore, kanë arrestuar trembëdhjetë (13) të dyshuar kosovarë, pasi të njëjtit në një lokal janë kapur në flagrancë duke luajtur bixhoz. Gjatë kontrollit, tek të dyshuarit janë konfiskuar vlera monetare të ndryshme, ndërsa tek njëri nga të dyshuarit, gjatë kontrollit në veturë i është gjetur dhe konfiskuar edhe një pistoletë me 8-fishekë. Me vendim të prokurorit, të dyshuarit janë dërguar në mbajtje”, thuhet në raportin e Policisë. [/Lajmi.net/](#)

LAJME TË FUNDIT

- 

Nxiti urrejtje mes grupeve etnike në Kosovë në...
- 

Gjobitet me 500 euro një kompani e autobusëve...
- 

Një javë nga vrasja në Hajvali, i dyshuari ende në arrati
- 


Autobusët e Podujevës nuk lejohen të kthehen nga...

Artikuj të ngjashëm



August 18, 2025

Nxiti urrejtje mes grupeve etnike në Kosovë në një festë me...



August 18, 2025

Gjobitet me 500 euro një kompani e autobusëve të Poodujevës që...



info@lajmi.net
Tel: +383 49 131 131
B.r. Zenel Salihu nr. 28, zyrra nr.

RRJETET SOCIALE



Other Links

- Fact-Checking Policy
- Ethics Policy
- Corrections Policy
- Ownership & Funding Information
- Editorial Team Information